



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E VITISË
OPSTINE VITINA
THE MUNICIPALITY OF VITI



Në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale nr. 04/L-144, Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës komunale të Qeverisë së Kosovës, Vendimit të Kuvendit Komunal të Vitisë Nr. 01-035702-880 për Inicimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë të pronës komunale të datës 29/09/2017, Vendimit për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimit të procedurave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim nr. 01-410/0356 dhe në bazë procesverbalit nr. 02/2018 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 25/04/2018, Komuna e Vitisë me datën 25/04/2018 shpall:

NJOFTIM PUBLIK
Nr.1/2018

Pranuar - Prillogje Me Datë 26.04.2018			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Shitje Prilog	Vlera Vredno
02-016/01-360			

**ANKAND PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR
TË PRONËS KOMUNALE**

NENI 1 : EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Komuna e Vitisë
Adresa : Rr 28 Nëntori, 61000 Viti
Personi kontaktus: Mifail Azizi
E-majli: mifail.Q.Azizi@rks-gov.net
Telefoni :044402130
Datë:25.04.2018

NENI II: LËNDA E SHITJES-ANKANDIT

Autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënie në shfrytëzim afat shkurtër prej 10 (dhjetë) viteve të pronës komunale: **Parcela kadastrale me nr-211/1, pronë e Komunës së Vitisë me spërfaqe prej 110000 m² në zonën kadastrale Devajë, destinohet të jepet në shfrytëzim për investim në nxjerrjen e mineraleve. Të drejtë pjesëmarrje në ankand kanë vetëm personat Juridikë.**

NENI III: INFORMATAT ADMINISTRATIVE

I: Kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje- dokumentet e kërkuara:

1. Deklarata nën betim e Operatorit ekonomik të nënshkruar dhe vulosur, se përmbush kushtet e përshtatshmërisë
2. Çertifikatën e rexhistrimit të biznesit -kopje
3. Çertifikatën e numrit fiskal -kopje

4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së - **Vërtetimi i ATK-së** (vetëm për fituesin).
5. Dëshmi nga Gjykata ekonomike se nuk është i dënuar – **Vërtetimi i Gjykatës Ekonomike** (vetëm për fituesin)
6. Dëshmi të kryerjes së obligimeve komunale – tatimi në pronë **Vërtetimi i tatimit në pronë** (vetëm për fituesin)
7. Plani investiv me paramasë dhe parallogari.

II: Kriteret që kërkohen për fituesin janë: Oferta e përgjegjshme ekonomikisht më e favorshme:

- Çmimi minimal i ofruar për m² 0.04 centë në vit, 50% të pikëve
 - Vlera e investimeve 25% të pikëve (investimet të jenë dhe do të vlersohen sipas çmimeve të tregut.
 - Numri i të punësuarve 25% të pikëve (konform vleres së investimeve).
-
- Afati për terheqjen e formularit të ofertave është deri me **21/05/2018**, Zyra e prokurimit nr.24 kati i 2 të, Komuna e Vitisë.
 - Afati i dorëzimit të ofertave në zarfa të mbyllur (një origjinal dhe një kopje) me **25/05/2018** deri në ora **13.30**, Zyra e prokurimit, Komuna e Vitisë.
 - Hapja e ofertave bëhet me **25/05/2018** në ora **14.00** në sallën e Drejtorisë së Administratës.
 - Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e ben komisioni i emëruar i Kuvendit të komunes të Vitisë në prani të përfaqësuesve të interesuar të kompanive që kanë ofertuar
 - Operatorët ekonomik të paknaqur me procesin e vlerësimit kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve në Komisionin Komunal për ankesa për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale i themeluar nga Kuvendi Komunal

Ky njoftim shpalllet në shpalljet e komunës, në mjetet e informimit publik dhe në Web faqen e Komunës së Vitisë.



Kryesuesi i Komisionit:
Mifail Azizi